



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 11
Prishtinë, më 19 Qershor 2013, në orën 10:00, salla S-II
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës

P R O C E S V E R B A L
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJEN E FINANCEVE PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Ali Sadriu, Mursel Haljilji, Valbona Dibra, Ramiz Lladrovci, Adem Grabovci, Imri Ahmeti, Afrim Hoti dhe Bali Muharremaj.

Munguan: Albert Kinolli.

Të ftuar: Rame Buja – Ministër i Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë dhe Lars Lage Olofsson - Auditor i Përgjithshëm.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Fatime Qorri, koordinatorë, Mehmet Simnica, zyrtar i fushës për ekonomi dhe Saranda Kelmendi, praktikante.

Mbledhjen e kryesoi: Ali Sadriu, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 29.05.2013;
3. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2012;
Të ftuar: z.Ramë Buja, Ministër dhe Lars Lage Olofsson-auditor i përgjithshëm.
4. Të ndryshme

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri, miratoi rendin e ditës pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 29.05.2013

Kryetari - Konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike e miratoi, njëzëri, pa vërejtje, procesverbalin e mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 29.05.2013.

3. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2012

Kryetari – Opinioni i Auditimit për vitin 2012 për MASHT-in është opinion i pakualifikuar. Vitin e kaluar ZAP ka dhënë 7 rekomandime, për MASHT dhe lidhur me këtë kjo e fundit ka përgatitur një plan veprimi për adresimin e rekomandimeve të dala nga raporti i auditimit. Mirëpo zbatimi i këtij plani të veprimit nga MASHT-i është duke u zbatuar me hapa të ngadalësuar. 2 rekomandime janë adresuar plotësisht, 4 prej tyre janë në proces, ndërsa 1 nuk është adresuar fare. Po ashtu edhe në buxhetin e mallrave dhe shërbimeve vërehet një shpenzim i vogël ku nga ndarja prej 10 milion euro ishin shpenzuar vetëm 7.8 milion euro apo 77% e ndarjes buxhetore, ndërsa kanë mbetur obligime të papaguara në këtë kategori ekonomike. Një mosbarazim në shumën prej 4,500 eurove në mes Universitetit të Prizrenit dhe Administratës së Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë. Mangësi gjatë procesit të furnizimit me libra- Gjatë rishikimit të procesit të furnizimit me libra vërejtëm këto mangësi: Nuk kishte kontrole të mjaftueshme gjatë pranimi të librave. Në disa raste ato nuk ishin pranuar në pajtim me kontratat si dhe disa raste tjera janë pranuar nga persona të paautorizuar. Në Gjashtë (6) shkollat që ka vizituar ZAP-i ka konstatuar se ka sasi të tepërt të librave. Gjithashtu ka hasur në raste kur me tituj të njëjtë të librave kanë furnizuar të dyja shtëpitë botuese. Kjo shihet nga Fletë-dërgesat që ZAP i ka marrë nga shkollat e vizituara. Nga auditori është vërejtur se ka mbi 560,000 libra si stoqe në këto shkolla që vlerësohet se kushtojnë mbi 1.2 milion euro. Vlefshmëria e sigurimit të ekzekutimit të projektit kishte skaduar-Tek gjashtë kontrata për ndërtimin e shkollave me vlerë të përbashkët prej 10,705,023€3, vlefshmëria e sigurimit të ekzekutimit të punimeve kishte skaduar. Kompensimi për orët e mbajtura nga Personeli Akademik në UPZ- Nga tetë rastet e testuara për vijueshmërinë e ligjëratave nga Personeli Akademik, në dy prej tyre u janë bërë pagesat ligjëruesve edhe pse nuk e kishin plotësuar normën e paraparë me kontratë (ishin të planifikuara 30 orë në semestër të angazhuar në dy lëndë, ndërsa kishin mbajtur vetëm nga 18 orë). Rregullorja për të ardhurat personale në UPZ, specifikon që mungesa nga procesi mësimor, sanksionohet me heqje të pjesshme të pagës për çdo orë të humbur të ligjëratës. Veprime të tilla nuk janë ndërmarrë nga ana e menaxhmentit. Menaxhimi i detyrimeve- Detyrimet në shumë prej 600,000€ pastaj 450,090€, si dhe disa shuma më të vogla, janë shumat e paguara në vitin 2012 ndërsa kanë rrjedhë si detyrime nga vitet e mëhershme. Të njëjtat nuk ishin prezantuar në pasqyrat financiare të viteve paraprake si detyrime. Pra, pasqyrat financiare nuk kanë qenë konsistente. Sistemi i auditimit të brendshëm-NJAB nuk kishte arritur ta përmbush plotësisht planin vjetor të auditimit, për shkak të numrit të vogël të stafit. Nuk janë përgatitur planet e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të NJAB, dhe nuk janë adresuar kënaqshëm rekomandimet e AB. Komiteti i auditimit gjatë vitit ishte takuar vetëm njëherë për të shqyrtuar raportet e AB.

Ramiz Lladrovci – Pyeti: ZAP ka identifikuar se ka tepër libra të shpërndara nëpër shkolla të cilat ishin audituar, edhe atë mbi 560,000 libra, po ashtu thuhet se në disa shkolla nxënësve ju janë shpërndarë me shumë se një libër, kjo në fakt i bie se MASHT nuk ka numër të sakte të nxënësve nëpër shkolla. Pyetja ime është se a ka evidence se sa nxënësve ju janë dhënë me shumë se një libër për lenden e njëjtë?

Afrim Hoti – Në bazë të një Marrëveshje të Mirëkuptimit të Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë dhe Komunës së Prizrenit në vitin 2004, kjo e fundit për ndarjen e një parcele toke në ndërtimin e Shkollës private të Gjimnazit në Prizrenit, me këtë MASHT mori përsipër pagesën e punëtorëve të kësaj shkolle në shumën prej 600,000 euro. Po ashtu edhe pse nuk është paraqitur në raport të ZAP-it nxënësit participojnë me mjetet e tyre deri në shumën prej

2,000 euro në vit. Si është e mundur të financohet shkolla private nga mjetet e Buxhetit shtetëror si dhe cili është përfitimi i shtetit nga kjo shkollë private? Po ashtu në raport të ZAP-it thuhet se për shkak të stafit të pamjaftueshëm ka mungesë të auditimeve të brendshme në MASHT. Pse nuk është bërë kjo, cilat ishin pengesat?

Bali Muharremaj – Tha se sipas Raportit në kategorinë e pagave dhe mëditjeve për MASHT janë shpenzuar 5.4 milion euro apo 94% e ndarjes buxhetore për këtë kategori ekonomike. Dhe nga kjo Auditori ka rekomanduar në këto të gjetura: *Kontratë e punës dhe kompensimet e tyre - Në tri raste, MASHT kishte nënshkruar me zyrtar kontrata të rregullta pune në pozita drejtuese, duke i paguar me pagë sekondare. Në kontratë nuk ishte precizuar koha e angazhimit të zyrtarit. Në bazë të shënimeve nga sistemi i Payrollit është vërejtur se zyrtarët e njëjtë kanë edhe kontratë të rregullt pune me pagë primare në një organizatë tjetër buxhetore. Po ashtu në UPZ gjatë vitit 2012 në tri raste ishin lidhur kontrata mbi vepër (të përkohshme) jashtë procedurave të konkursit. Në tri raste në UPZ ishin bërë kompensimet për punë shtesë, pa dëshmi apo raporte për punën e kryer. Përfituesit janë punonjës të rregullt në Universitetin e Prishtinës. Mungesë dokumentacioni për punëtorët- Nëntë zyrtarë të cilët janë të angazhuar në burgun e Dubravës paguhen nga MASHT. Zyrtarët përgjegjës të Ministrisë nuk kanë mundur të na ofrojnë dosjet e as kontratat e këtyre zyrtarëve, në bazë të të cilave janë bërë pagesat e pagave. Sipas menaxherit së personelit MASHT nuk ka dokumentacion relevant për këta zyrtar. Pagesa e Avanceve ndaj Operatoreve Ekonomik-Sipas ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2012, Operatorëve Ekonomik (OE) fitues të projekteve për kryerjen e punimeve apo shërbimeve në muajin nëntor nuk do të ketë pagesa të paradhënies mbi (10%) dhe në dhjetor mbi pesë (5%) të vlerës së kontratës dhe atë, vetëm pas aprovimit nga Ministri i Financave. ZAP ka gjetur se për kontratat e mëposhtme janë paguar avance: Për “Ndërtimin e Murit Mbrojtës në Kaçanik” në vlerë prej 995,508€ është paguar në avancë shuma prej 149,326€; Për “Ndërtimi i shkollës fillore në Çyshk Pejë” në vlerë prej 1,152,758€, ishte paguar në avancë shuma 100,000€; Për “Vazhdimi i punimeve në shkollën fillore” Shtime në vlerë prej 73,773€ ishte paguar në avancë shuma prej 11,065€. Të gjitha këto avance janë paguar në muajin nëntor 2012. Ne nuk kemi marrë dëshmi nga MASHT se për pagesën e këtyre avanceve ishin marrë aprovimet e nevojshme paraprakisht.*

Valbona Dibra - Në këtë rast kemi të bëjmë me një raport të rregullsisë dhe opinionin ndërtohet se si janë përgatitë pasqyrat financiare. Kjo nuk mund të kontestohet dhe në këtë rast ZAP ka dhënë një opinion të pakualifikuar d.m.th auditori ka qenë i kënaqur në të gjitha aspektet materiale të kësaj Ministrie. Kërkesë e vazhdueshme imja ka qenë për auditime të performancës. Sa i përket pasqyrave financiare institucionet janë vetëdijesuar dukshëm, ka një legjislacion adekuat, por vazhdoj të insistoj në auditime të performancës. Po ashtu kam insistuar në vazhdimësi që tekstet shkollore të shfrytëzohen nga nxënësit për më shumë vite, pastaj të përgatitet rregullore që në rast të dëmtimit të librit, librin ta paguaj nxënësi. Në këtë mënyrë do të kursehet buxheti i shtetit. Pres nga ministri që të na arsyetoj çështjen e stoqeve. Lidhur me këtë duhet të mendohet rreth mënyrës së shpërndarjes së teksteve shkollore. Nëse Ministria nuk i merr në menaxhim tekstet është rreziku i manipulimit me to. Shkolla bënë kërkesën për nevoja adekuate dhe ministria e adreson atë kërkesë. Kjo do të evitonte mundësinë e keqpërdorimeve. Fakt i mirë është që ka shumë të arritura në dikastere të Qeverisë, por nuk përjashtohen gabimet. Auditimi i brendshëm ka funksionuar, por shprehet nevoja për staf shtesë, besoj ministri e ka këtë parasysh.

Murselj Haljilji – Opinioni i dhënë është i mirë për MASHT. Pyeti Ministrin se a ka qenë i informuar paraprakisht lidhur me shumën e mjeteve për borxhet të cilat nuk ishin paraqitur në Pasqyrat Vjetore Financiare të vitit të kaluar si dhe a ka pasur ankesa në ministri për këtë apo ankesa gjyqësore? Kërkoj sqarim edhe lidhur me Vendimin e ministrit për shfrytëzimin e automjeteve zyrtare brenda 24 orëve, si dhe pajisjen e zyrtareve të MASHT-it me kompjuter, dhe në raport të ZAP-it thuhet se asnjë zyrtar në rastin e intervistimit nga ZAP, nuk kishte llaptopët në vendin e punës, po ashtu në raport të ZAP-it nuk thuhet se sa ishte numri i këtyre

pajisjeve? Po ashtu me intereson çështja e funksionalizimi i kabineteve, si te Fizikes, Kimisë Edukatës Fizike në kontest të ngritjes së cilësisë profesionale të nxënësve nëpër shkolla. A mund të na jepni ndonjë të dhënë lidhur me këtë pyetjen e fundit sepse në raport të ZAP-it nuk i kemi?

Artan Venhari- zv. Auditor - Opinioni i dhënë në raportin e MASHT-it është opinion i pakualifikuar dhe nga kjo auditori ka marrë nga MASHT planin e veprimit lidhur me adresimin e rekomandimeve, nga kjo vërehet progres në të gjitha fushat, një rekomandim ZAP-it është adresuar gabimisht, sepse edhe ky rekomandim është në proces të zgjedhjes.

Ramë Buja -Ministri MASHT – Ne kemi ndërmarrë dhe do të ndërmarrim masa në vazhdimësi në adresimin e rekomandimeve. **Mos harmonizimi i të hyrave** - veprimet tona ndërmarra posedimi nga pika 4.4 raporti i të hyrave vetanake është faktike edhe pas shumë përpjekjeve nuk është arritur të barazohen me MASHT kjo shumë parasheh .Diferenca prej 4.500 euro ekziston ku UPZ po bënë përpjekje që t'i rregulloj format e pagesave për të hyrat e raportuara në MASHT deri te ky problem ka ardhur për shkak se UPZ-ja bënë barazimin e të hyrave sipas datës kur janë kryer pagesat në bankë, ndërsa në MASHT sipas datës kur janë raportuar të hyrat nga banka. **Vonesa në inkasimin e të hyrave** - deri në vitin 2012 të muajit qershor universitetet publike nuk kanë qenë të obliguara që të bëjnë pagesën për akreditim po në UA për akreditimet e institucionit të arsimit të lartë universitetet publike duhet të bëjnë pagesë për akreditim. Universiteti i Prishtinës në buxhetin e vitit 2012 nuk ka pas mjete financiare që të bëjë pagesën për akreditim, por me fillimin e vitin financiar 2013 ka likuiduar një pjesë të obligimeve për vitin 2012 me vlerë prej 20 mijë euro. Tani është në procedurë të pagesës edhe të një pjese të obligimeve me vlerë prej 60 mijë euro. UP me rishikim të buxhetit ka kërkuar fonde shtesë për kryerjen e obligimeve të akreditimit. **Dhënia e objekteve me qira, jo transparente**- bazuar në ligjin në fuqi nuk ka nevojë të përdorën procedura të prokurimit dhe qendra e studentëve duhet të bëjë shpallje të interes publik për dhënie me qira të lokaleve afariste. Objekti i qendrës së mjekësisë familjare i cili gjendet afër qendrës së studentëve nuk është në funksion për shkak se Kuvendi Komunal i Prishtinës me vendimin e saj numër 031/4463 të datës 20.09.2006 ka tërhequr stafin nga qendra e Mjekësisë Familjare dhe Qendra ka bërë kërkesë për inventarizimin e saj, por nuk ka marrë përgjigje pozitive nga Kuvendi Komunal. **Mos aprovimi i tarifave nga ana e Bordit Drejtues** - qendra e studentëve disponon me vendimin numër 111 të datës 26.04.2013, me të cilën janë përcaktuar çmimet për banim të profesorëve në konviktet VI dhe VII. **Mangësi gjatë procesit të furnizimit me libra**– Menaxhmenti i MASHT-it me të marrë informacione nga auditori për tepricën e librave nëpër shkolla ka marrë hapa konkret për eliminimin e tyre dhe ka formuar komisione të cilat kanë konstatuar zgjedhje të cekura që janë sistemuar nëpër objekte shkollore të regjistruar për vitin 2013 dhe 2014 të përdorura për nevojat e nxënësve duke e zvogëluar kërkesën për këtë sasi të librave. Menaxhmenti i MASHT-it në bashkëpunim me drejtorin komunal ka marrë hapa që të gjenden modele si për kërkesa edhe për shpërndarjen e librave. Kemi pas edhe shpërpunime të numrave të nxënësve nga komunat për shkak të granteve që të përfitojnë, prandaj kërkojmë edhe ndihmën e juaj si komision për ta zgjidhur këtë. **Vlefshmëria e sigurimit të ekzekutimit të projektit kishte skaduar** - Në të ardhmen do t'ju kushtohet më shumë vëmendje për afatet e skadimeve të sigurimeve të ekzekutimit. Zbatimi i ligjit në përgjithësi është në procedurë dhe do të përpiqemi të bëjmë ashtu siç është më së miri. **Pagesa e Avanceve ndaj Operatoreve Ekonomik** – Për ndërtimin e murit mbrojtës të Kaçanikut avanci është kryer sipas avanceve ligjore të aplikueshme 15% lënda e datës 31.10.2012. Në muajin nëntor lejimi i pagesës sipas ligjit të pagesës është 10% ndërsa në rastin e tillë pagesa është më e ulët se sa parashihet me ligj, në mungesë të mjeteve blerja është kryer me 23.11.2012 avanci për punimet e Shkollës në Shtime me vlerë prej 11, 650 euro është përfunduar me kohë dhe afatet e parapara me Ligj.

Regjistrimi i shpenzimeve në kode jo adekuate - e pranojmë se janë përdorë kode të ndryshme buxhetore për dy pagesa 1,060 euro dhe 1,182 euro me një organizim më të mirë në të ardhmen të procedurave për pagesa dhe sipas kodeve ekonomike do të përpiqemi që kjo të mos ndodh. Qendra e studentëve ka bërë kërkesë pranë MASHT-it dhe Ministrisë së

Financave për hapjen e kodit për buxhetin kapital, sepse është i nevojshëm një kod i tillë duke pasqyruar që qendra e studentëve çdo vit duhet të bëjë renovime të konvikteve. Këtij komenti ja bashkangjesim kopjen e kërkesës të drejtuar MASHT-it 16.05.2012 numri i protokollit 2266 të kërkesës që nuk është aprovuar nga Ministria e Financave. Kërkesa është bërë edhe këtë vit për bartje nga kodi i mjeteve në kodin për mallra dhe shërbime nëse kjo arrihet menaxhmenti i Qendrës do t'i kryej pagesat në bazë të ligjit nga kodi i investimeve kapitale. Qendra e studentëve nga pranimi i draft raportit të auditimit ka filluar aplikimi e mbajtjes së rregullt të evidencës. Detyrat e vazhdueshme menjëherë pas pranimi të raporteve dhe kjo po vazhdon edhe më tutje. **Kontratat e punës dhe kompensimi i tyre** – Në rast të pranimi të tre punëtorëve për shkak të nevojave të paraqitura duhet të eliminohen në të ardhmen akoma nuk janë eliminuar. Kompensimi për punën shtesë të punëtorëve do të bëhet pas verifikimit të punës së kryer dhe kjo do të bëhet në bashkëpunim me bordin e UPZ. **Mungesë dokumentacioni për punëtorët - me vendim të sekretarit të përgjithshëm që nga data 01.01.2013 të gjithë punëtorët e burgut nuk janë pjesë e listave të MASHT-it. Ekzekutimi i pagave edhe pas shkuarjes në detyrën e re** - Që nga janari 2013 zyrtari në fjalë nuk është më në listën e pagave dhe menaxhmenti i MASHT-it ka kërkuar kthimin e mjeteve. Po kontrollohen orët e punës të stafit të angazhuar dhe pagesat po bëhen në këtë mënyrë: pagesa e bëra punëtorëve të theksuar në raport do të ndalin punëtorëve që i kanë marrë këto pagesa. **Kontratat mbi kryerjen e shërbimeve të veçanta** - Me vendimin e ministrit 07501B të datës 29.05.2013 kryesuesi i anëtarëve të bordit realizojnë paga shtesë sipas udhëzimit administrativ të Qeverisë së Kosovës numër 12.2007 për unifikimin e pagave shtesat e kryetarëve kryesuesve si dhe anëtarëve të bordeve këshillave anëtarëve të komisioneve gjegjëse. **Shpenzim i pa planifikuar i Subvencionit- Prioriteti** - MASHT-it duhet të respektoj rekomandimet dhe të bëjë përpjekje që të hartoj një kornizë juridike ku duhet të specifikohen qartë të gjitha kushtet mbi ndarjen e subvencioneve. **Inventarizimi i pasurisë dhe testimi i pasurisë** - UPZ-ja ka arritur t'i bëjë evidencat e pasurive në harmoni me ligjin tash ka arritur t'i realizojë. **Menaxhimi i automjeteve dhe pajisjeve** - MASHT-it në bazë të nenit 145 pika 2 të Kushtetutës së Republikës Kosovës duke marrë parasysh nenet 4,21 dhe 22 të Ligjit 03.08.189 për administratën e Republikës së Kosovës duke u bazuar në nenin 8 të paragrafit 1. 4 të shtojcës 6 të rregullores 02. 2011 të fushave administrative të zyrave të ministrave dhe kryeministrave 23.08.2011 dhe udhëzimit administrativ të Qeverisë 03.2008 për përdorimi të automjeteve të Qeverisë së Kosovës, ka marrë vendim që është cilësuar nga auditori. Një numër i zyrtarëve posedojnë edhe laptop, mirëpo numrin e saktë të tyre nuk e kemi këtu.

Ramiz Lladrovci – Lidhur me përdorimin e veturave pyeti: kush kontrollon përdorimin e veturave. A regjistrohet lëvizja e çdo makine për çdo ditë?

Kryetari – MAP ka hartuar një program GPS , për kontroll të përdorimit të veturave, që i dedikohet gjithë qeverisë. Ky program eliminon parregullsitë dhe racionalizon shpenzimet. Në këtë drejtim vetëm MD po e zbaton! Kërkoj sqarim lidhur me këtë.

Sekretari MASHT - Kanë mbetur shumë pak vetura që nuk kanë GPS, është çështja e Administratës Publike në vonesat e vendosjen e këtyre pajisjeve kanë mbetur edhe 4 apo 5 vetura. Dhe përmes këtyre pajisjeve përcillen lëvizjet nga zyra ime përmes kompjuterit.

Adem Grabovci– U interesua për datat se kur ka filluar apo deri ku ka arritur MASHT në vendosjen e GPS dhe kontrollin e përdorimit të veturave zyrtare. Është papërgjegjësia më e madhe që i përcjell institucionet tona dhe keqpërdorimi më i madh. Kërkojmë nga Ministri që të ushtroj ndikimin e tij në Qeveri që kjo dukuri negative të ndërpritet.

Ramë Buja Ministër, MASHT - Menaxhimi i detyrimeve –Siç dihet obligimet e viteve paraprake kalojnë në vitin vijues, por rekomandimet në vijim kanë filluar të aplikohet në fillim të vitit 2013, është fjala për 600 mijë euron. **Plani i Auditimit të Brendshëm dhe implementimi i rekomandimeve** - Shkaku kryesor ka qenë mungesa e buxhetit për mos shtim

të numrit të punëtorëve të kjo njësi. Në vazhdimësi që dy vite kemi bërë kërkesë në MF që të rritet numri i punëtorëve, Ministria e Financave ka refuzuar kërkesën tonë. **Çështja e kabinetëve** - për çdo vit po shtohen sektor të ndryshëm në shkolla në gjithë rajonin e Kosovës nuk mund të them me saktësi por një dit tjetër do t'ju sjell saktë informacionet se cilat shkolla janë pajisur. Ndërsa sa i përket përfitimit të shtetit është se ajo shkollë është në mesin e shkollave më cilësore që ka Kosova, por me ligjin dhe marrëveshjen ndërkombëtare kemi një shpërputhje. Një marrëveshje është nënshkruar në 2004 nga ministri i që ishte në atë kohë se marrëveshja ndërkombëtare obligon ministrin e ardhshëm që të paguajnë një shumë të tillë shtesë së pagesës se arsimtarëve. Ata kanë pagesën nga institucioni ku punojnë, por me marrëveshje është që një shtesë pagese për t'ja plotësuar pagesën që është shënuar dhe kjo shumë është 600 mijë euro.

Valbona Dibra - Para Komisionit Ministri Hamza ka premtuar vazhdimisht që do të përkrahë çdo kërkesë që ka të bëjë me fuqizimin e sektorit të auditimit të brendshëm. Nuk di se pse nuk e ka përkrahur kërkesën tuaj për rritjen e numrit të punëtorëve në këtë sektor. Kërkesa duhet të jetë për auditor të brendshëm e jo për rritje të stafit në përgjithësi.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri nxori këtë

Përfundim

1. Kërkohet nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në afatin prej tre muajve të dorëzoj Raport me shkrim lidhur me:

- Numrin e saktë të shkollave në Republikën e Kosovës,
- Numrin e saktë të nxënësve si dhe
- Numrin e saktë të mësimeve në këto shkolla.

4. Të ndryshme

a). Organizimi i punëtorisë

Kryetari - Njoftoi anëtarët e Komisionit për organizimin e një punëtorie, ku do të hartohet plani për shqyrtimin e Raportëve të procedurës në Kuvend nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm. Po ashtu Komisioni në këtë takim do të rishqyrtoj planin financiar të Komisionit, angazhimin e ekspertëve si dhe bashkëpunimin me Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm. Ndër të tjera Komisioni do të shqyrtoj edhe Raportin e auditimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Valbona Dibra – Përkrah iniciativën për këtë punëtori. Ndoshta në kohën sa më të shkurtër dhe me propozimet e sotme do të marrim agjendën e detajuar rreth këtij organizimi. Është shumë e rëndësishme që Komisioni të hartoj planin se me cilat raporte do të merret për shqyrtim, me qëllim që të trajtohen ato që janë me të gjetura më të mëdha dhe me interes për qytetarin.

Propozoi që Komisioni të organizoj një vizitë zyrtare në Shqipëri, konkretisht në Kontrollin e Lartë të Shtetit.

Kryetari – Ndau mendimin me deputeten Dibra, por tha duhet të kemi parasysh që Shqipëria tani është në kohën e zgjedhjeve. Kemi pasur kontakte dhe jemi në pritje të një përgjigje.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri nxori këtë

Vendim

1. Komisioni për Mbikëqyrje e Financave Publike me datën 24-26 Qershor 2013, organizon punëtori - mbledhje në Hotel ‘Sharri’ Prevallë, në të cilën do të hartoj planin për shqyrtimin e Raporteve të proceduara në Kuvend nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm. Po ashtu Komisioni në këtë takim do të rishqyrtoj planin financiar të Komisionit, angazhimin e ekspertëve si dhe bashkëpunimin me Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm. Ndër të tjera Komisioni do të shqyrtoj edhe Raportin e auditimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

2. Shpenzimet për organizimin e kësaj punëtorie barten nga buxheti i Komisionit.

b). Njoftimi nga udhëtimi zyrtar në Londër

Kryetari - Njoftoi anëtarët e Komisionit lidhur me vizitën e realizuar në Londër. Lidhur me këtë është përgatitur dhe dorëzuar Njoftimi për deputetët e Kuvendit dhe Kryesinë e Kuvendit, sipas Rregullores së Kuvendit.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Ali Sadriu